|--------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Sinonimet          | CI e gjelbër natyrale 5, Klorofil Baker Natriumi, Klorofil Bakër Kaliumi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Përkufizimi        | Kripërat alkaline të klorofilës së bakrit përftohet nga shtimi i bakrit në një produkt të përftuar nga sapunifikimi i një ekstrakti të një ekstraktimi me tretës të shtameve natyrore të materialeve të bimëve të ngrënshme, barit, jonxhës dhe hithërve. Sapunifikimi largon grupet estere të metilit dhe fitolit dhe mundet pjesërisht të çaj unazën e ciklopentenilit. Pas shtimit të bakrit në klorofilat e pastruara, grupet acide janë neutralizuar për të formuar kripërat e kaliumit dhe/ose natriumit.<br>Vetëm tretësit e mëposhtëm mund të përdoren për ekstraktim: acetoni, metil etil keton, diklormetan, dioksidi i karbonit, metanol, etanol, propan-2-ol dhe heksan. |
| Klasa              | Porfirin                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Indeksi ngjyrës No | 75815                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Einecs             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Emri kimik         | Principet ngjyuese kryesore janë:<br>3-(10-Karboksilat-4-etil-1,3,5,8-tetrametil-9-oxo-2-vinilforbin-7-yl)propionat, kompleks bakri (Klorofil Baker a)<br>dhe<br>3-(10-Karboksilat-4-etil-3-formil-1,5,8-trimetil-9-okso-2-vinilforbin-7-yl)propionat, kompleks bakri (Klorofil Baker b)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Formula kimike     | Klorofilin bakri a (forma acide): $C_{34}H_{32}CuN_4O_5$<br>Klorofilin bakri b (forma acide): $C_{34}H_{30}CuN_4O_6$                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Pesha molekulare   | Klorofilin bakri a: 640,20<br>Klorofilin bakri b: 654,18<br>Secila mund të rritet me 18 dalton nëq unaza ciklopentenilit është çare.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Hiri               | Përmbajtja në total i Klorofilave është jo më pak se 95% në mostër të tharë në 100°C për 1 orë.<br><br>$E_{1\text{ cm}}^{1\%}$ 565 në 405 nm në tretësirë ujore bufer fosfat në pH 7.5<br><br>$E_{1\text{ cm}}^{1\%}$ 145 në 630 nm në tretësirë ujore bufer fosfat në pH 7.5                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Përshkrimi         | Pudër jeshile e errët në blu/e zezë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Identifikimi       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| A.Spektrometrik    | Maksimumi në tretësirë ujore bufer fosfat në pH 7.5 në 405 nm dhe në 630 nm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Pastërtia          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Mbetjet e tretësve | Aceton<br>Metil etil keton<br>Metanol<br>Etanol<br>Propan-2-ol<br>Heksan<br>Diklormetan: Jo më shumë se 10 mg/kg<br>Jo më shumë se 50 mg/kg vetëm ose të kombinuara                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Arseniku           | Jo më shumë se 3 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Plumbi             | Jo më shumë se 10 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Mërkuri            | Jo më shumë se 1 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Kadmiumi           | Jo më shumë se 1 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Jone bakri         | Jo më shumë se 200 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Bakri përgjithshëm | Jo më shumë se 8,0 % në faeofitin bakri i përgjithshëm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |



## E 142 JESHILE S

|                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|--------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Sinonimet                                        | CI blu ushqimi 5                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Përkufizimi                                      | Jeshile S konsiston në thelb në natrium N-[4-(dimetilamin)fenil] 2-hidroksi-3,6-disulfo-1-naftalenil]metilen]-2,5-cikloheksadien-1-yliden]-N-metilmetanamin dhe në lëndë ngjyuese shtesë së bashku me klorur natriumi dhe /ose sulfat natriumi dhe/ose sulfat kalciumi si komponentë kryesorë të pangjyrosur.<br>Jeshile S është një kripë natriumi. Kripa e kalciumit dhe kaliumit është gjithashtu e lejuar. |
| Klasa                                            | Triarilmetan                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Indeksi ngjyrës No                               | 44090                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Einecs                                           | 221-409-2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Emri kimik                                       | Natrium N-[4-[[4-(dimetilamin)fenil](2-hidroksi-3,6-disulfo-1-naftalin)-metilen]2,5-cikloheksadien-1-yliden]-N-metilmetanamin;<br>Natrium 5-[4-dimetilamin-α-(4-dimetiliminociklohexa-2,5-dienylidene)benzyl]-6-hydroxy-7-sulfonato-naphthalene-2-sulfonate (emri kimik alternativ).                                                                                                                           |
| Formula kimike                                   | C <sub>27</sub> H <sub>25</sub> N <sub>2</sub> NaO <sub>7</sub> S <sub>2</sub>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Pesha molekulare                                 | 576,63                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Hiri                                             | Përmban jo më pak se 80% të lëndës ngjyuese totale e llogaritur si kripë natriumi<br>E <sub>1 cm</sub> <sup>1%</sup> 1720 në 638 nm në tretësirë ujore                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Përshkrimi                                       | Granula ose pluhur blu i errët ose jeshile e errët                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Identifikimi                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| A. Spektrometrik                                 | Maksimumi në ujë në 632 nm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| B. Tretësirë blu ose jeshile në ujë              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Pastërtia                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Lëndët e patretshme në ujë                       | Jo më shumë se 0.2%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Lëndët ngjyuese shtesë                           | Jo më shumë se 1.0%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Komponimet organike të tjera nga lëndët ngjyuese |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| 4,4'-bis (dimetilamino) – alkool benzidril       | Jo më shumë se 0.1%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 4,4'-bis (dimetilamino) - benzofenon             | Jo më shumë se 0.1%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 3-hidroxinaftalen-2,7-acid disulfonik            | Jo më shumë se 0.2%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Aminat aromatike primare të pasulfonuara         | Jo më shumë se 0.01% (e llogaritur si anilinë)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Lëndë të ekstraktueshme në eter                  | Jo më shumë se 0.2% në kushte neutrale                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Arseniku                                         | Jo më shumë se 3 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Plumbi                                           | Jo më shumë se 10 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Mërkuri                                          | Jo më shumë se 1 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Kadmiumi                                         | Jo më shumë se 1 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Metalet e rënda (si Pb)                          | Jo më shumë se 40 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |

**E 150a KARAMEL I HAPUR**

|                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|---------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përkufizimi                                       | Karameli i hapur është përgatitur nga trajtimi i kontrolluar në të nxehtë të karbohidrateve (komercialisht ushqimet e vlefshme si ëmbëltues nutritive të cilat janë monomerë glukozë dhe fruktozë dhe / ose polimerët e tyre, p.sh. shurup glukozë, shurup sukrozë, dhe / ose sukros dhe dekstrozë). Për të promovuar karamelizimin, acidet, alkalet dhe kripërat mund të përdoren, me përjashtim të komponimeve të amonit dhe sulfiteve. |
| Klasa                                             | Triarilmetan                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Indeksi ngjyrës No                                | 44090                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Einecs                                            | 221-409-2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Emri kimik                                        | Natrium N-[4-[[4-(dimetilamin)fenil](2-hidroksi-3,6-disulfo-1-naftalin)-metilen]2,5-cikloheksadien-1-yliden]-N-metilmetanamin;<br>Natrium 5-[4-dimetilamin-α-(4-dimetiliminociklohexa-2,5-dienylidene)benzyl]-6-hydroxy-7-sulfonato-naphthalene-2-sulfonate (emri kimik alternativ).                                                                                                                                                      |
| Formula kimike                                    | C <sub>27</sub> H <sub>25</sub> N <sub>2</sub> NaO <sub>7</sub> S <sub>2</sub>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Pesha molekulare                                  | 576,63                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Hiri                                              | Përmban jo më pak se 80% të lëndës ngjyruese totale e llogaritur si kripë natriumi<br>E <sub>1 cm</sub> <sup>1%</sup> 1720 në 638 nm në tretësirë ujore                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Përshkrimi                                        | Granula ose pluhur blu i errët ose jeshile e errët                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Identifikimi                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| A. Spektrometrik                                  | Maksimumi në ujë në 632 nm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| B. Tretësirë blu ose jeshile në ujë               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Pastërtia                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Lëndët e patretshme në ujë                        | Jo më shumë se 0.2%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Lëndët ngjyruese shtesë                           | Jo më shumë se 1.0%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Komponimet organike të tjera nga lëndët ngjyruese |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 4,4'-bis (dimetilamino) – alkool benzidril        | Jo më shumë se 0.1%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 4,4'-bis (dimetilamino) - benzofenon              | Jo më shumë se 0.1%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 3-hidroxinaftalen-2,7-acid disulfonik             | Jo më shumë se 0.2%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Aminat aromatike primare të pasulfonuara          | Jo më shumë se 0.01% (e llogaritur si aniline)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Lëndë të ekstraktueshme në eter                   | Jo më shumë se 0.2% në kushte neutrale                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Arseniku                                          | Jo më shumë se 3 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Plumbi                                            | Jo më shumë se 10 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Mërkuri                                           | Jo më shumë se 1 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Kadmiumi                                          | Jo më shumë se 1 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Metalet e rënda (si Pb)                           | Jo më shumë se 40 mg/kg                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

**UDHËZIM****Nr. 17, datë 22.12.2014****PËR MONITORIMIN E  
TEMPERATURAVE NË MJETET E  
TRANSPORTIT, MAGAZINIMIN DHE  
RUAJTJEN E USHQIMEVE NË  
NGRIRJE TË SHPEJTË TË DESTINUAR  
PËR KONSUM NJERËZOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 23, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave në lidhje me monitorimin e temperaturave në mjetet e transportit, magazinimin dhe ruajtjen e ushqimeve në ngrirje të shpejtë të destinuar për konsum njerëzor.

2. Mjetet e transportit, të magazinimit dhe të ruajtjes së ushqimeve me ngrirje të shpejtë, të pajisen me instrumente të përshtatshme regjistrimi për të monitoruar në intervale të shpeshta dhe të rregullta, temperaturën e ajrit në të cilat ushqimet me ngrirje të shpejtë janë vendosur.

3. Operatorët e biznesit ushqimor duhet të mbajnë të gjitha dokumentet që lejojnë verifikimin se instrumentet e përmendura më sipër janë në përputhje me standardet në fuqi.

4. Temperatura e regjistruar të jetë datuar dhe e ruajtur nga operatori i ushqimit për një periudhë prej të paktën një viti, ose për një periudhë më të gjatë duke marrë parasysh natyrën dhe datën e skadencës së produkteve ushqimore në ngrirje të shpejtë.

5. Pa anashkaluar pikat 2, 3 dhe 4, temperatura e ajrit gjatë ruajtjes në ambientet me ekspozim, me pamje qartësisht të dukshme të shitjes me pakicë dhe në ambientet e shpërndarjes, të matet nga një termometër lehtësisht i dukshëm.

Në rastin e ambienteve të hapura të shitjes me pakicë:

a) kufiri i ngarkesës maksimale të ambientit duhet të jetë shënuar në mënyrë të qartë;

b) termometri që tregon temperaturën në ajër të kthehet në krah të markimit të nivelit.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit mund të bëjë përjashtim nga kërkesat e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 në rastin e frigoriferëve me më pak se 10 m<sup>3</sup>, për magazinimin e stokeve në shitjen me

pakicë, kështu që lejohet që temperatura e ajrit të matet nga një termometër lehtësisht i dukshëm.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT  
RURAL DHE ADMINISTRIMIT  
TË UJËRAVE  
**Edmond Panariti**

**UDHËZIM****Nr. 17/1, datë 22.12.2014****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE  
PËR PRODHIMIN, PËRPUNIMIN,  
SHPËRNDARJEN E PRODUKTEVE ME  
ORIGINË SHTAZORE PËR KONSUM  
NJERËZOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 23, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve të marra prej tyre të destinuar për konsum njerëzor.

2. Për qëllime të këtij udhëzimi të zbatohen përkufizimet e dhëna në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrë masa për të siguruar që operatorët e biznesit ushqimor në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së produkteve me origjinë shtazore nuk shkaktojnë përhapjen e sëmundjeve ngjitëse tek kafshët.

4. Produktet me origjinë shtazore të merren nga kafshët të cilat plotësojnë kushtet e shëndetit të kafshëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për veterinarinë.

5. Produktet me origjinë shtazore të merren nga kafshët:

a) të cilat nuk vijnë nga një fermë, stabiliment, territor ose pjesë e një territori që i nënshtrohen masave kufizuese në lidhje me shëndetin e kafshëve të zbatueshme për kafshët dhe produktet me origjinë shtazore;

b) të cilat, në rastin e mishit dhe produkteve



të mishit, nuk janë therur në një stabiliment në të cilin janë kafshët e infektuara ose dyshohet se janë të infektuara me një nga sëmundjet, të cilat mbulohen nga rregullat e përcaktuara në shtojcën e këtij udhëzimi, ose kur karkasat ose pjesë të saj nga kafshë të tilla, ishin të pranishëm gjatë therjes ose procesit të prodhimit, përveç kur një dyshim i tillë ka qenë i përjashtuar.

6. Pavarësisht nga pika 3, 4 dhe 5, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit mund të autorizojë prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e produkteve me origjinë shtazore që vijnë nga një territor ose një pjesë e territorit që i nënshtrohet masave kufizuese në lidhje me shëndetin e kafshëve, por të cilat nuk vijnë nga një fermë e infektuar apo dyshohet se është e infektuar, me kusht që:

i) para se t'i jenë nënshtrohur trajtimit të përmendur më poshtë, produktet janë marrë, trajtuar, transportuar dhe ruajtur të ndara ose në kohë të ndryshme, nga produktet të cilat plotësojnë të gjitha kushtet e shëndetit të kafshëve dhe kushtet për transport jashtë territorit, i cili ka qenë subjekt i masave kufizuese në lidhje me shëndetin e kafshëve, kanë qenë të

miratuar nga autoriteti përgjegjës;

ii) produktet, të cilat i janë nënshtrohur trajtimit janë identifikuar në mënyrë të qartë;

iii) produktet i nënshtrohen trajtimit të përshtatshëm, që problemi i cili ka lidhje me shëndetin e kafshëve të eliminohet, trajtimi të bëhet në përputhje me shtojcën e këtij udhëzimi, e cila përcakton një tabelë me listën e trajtimeve që aplikohen në produktet me origjinë shtazore për të eliminuar rreziqet e shëndetit të kafshëve, të cilat lidhen me mishin dhe qumështin;

iv) trajtimi është aplikuar në një stabiliment të miratuar për këtë qëllim nga autoriteti kompetent.

7. Ngarkohen Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT  
RURAL DHE ADMINISTRIMIT  
TË UJËRAVE  
**Edmond Panariti**



## SHTOJCË

LISTA E TRAJTIMEVEQË APLIKOHEN NË PRODUKTET ME ORIGJINË SHTAZORE PËR TË ELIMINUAR RREZIQET QË VIJNË NGA SHËNDETI I KAFSHËVE TË CILAT LIDHEN ME MISHIN DHE QUMËSHTIN

